

VENDIM
Nr.330, datë 25.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
HYRËSE PËR NË QENDRËN E RIINTEGRIMIT TË TË MITURVE, NË KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës hyrëse për në Qendrën e Riintegritimit të të Miturve, në Kavajë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 476 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m² tokë arë, me vlerë shpronësimi 15 290 (pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë/m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 278 040 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyzet) lekë.

4. Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, t’i shtohet fondi 7 278 040 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyzet) lekë, nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda datës 20 prill 2009.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lista emërore e pronarëve që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të Qendrës së
Riintegritimit për të Mitur në Kavajë

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi m ² /lekë	Vlera (lekë)
1.	Bashkëpronarët e familjes Tuka	8551	6/117	Arë	476	15 290	7 278 040